
RECENSIONE

KRISTAQ PRIFTI: "POPULLSIA E KOSOVËS (1831-1912)",
Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,
Shtëpia botuese "Kristalina-KH", Tiranë, 2014, 1061 f.

Historiani shqiptar, akademik Kristaq Prifti është i njohur për kontributin e rëndësishëm që ka dhënë për historiografinë shqiptare, sidomos për historiografinë e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë së sotme. Nga pena e tij kanë parë dritën e botimit monografitë: "Doktor Ibrahim Temo", "Dervish Hima", "Lidhja Shqiptare e Pejës: Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1896-1900". Njëherësh ka qenë pjesë e grupit drejtues të botimit "Historia e Popullit Shqiptar" në katër vëllime, ka qenë mandej bashkorganizator i simpoziumit "Shqiptarët e Maqedonisë", që u mbajt në Shkup në vitin 1992, si edhe redaktor i pjesës historike të punimeve të tij (1994). Kontributi i tij vërehet gjithashtu në botimin e përmbledhjes "E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi" (Tiranë, 1990), në organizimin e simpoziumit "Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual" etj.

Së fundi, akademik Kristaq Prifti e ka begatuar historiografinë shqiptare me veprën e demografisë historike që titullohet "Popullsia e Kosovës 1831-1912", e botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Kjo vepër vëllimore e tij, përbën interes të veçantë shkencor, edhe për historiografinë e vendeve ballkanike dhe të Evropës Juglindore.

Veprën e akademik Kristaq Priftit e bëjnë me peshë shkencore e të qendrueshme disa faktorë kyç, të domosdoshëm, që janë si parakusht i një studimi të karakterit të mirëfillt shkencor. Komponenti i parë është shfrytëzimi i lëndës nga fondet e shumta arkivore, që autori i ka vjelë në Arkivin Osman të Kryeministrisë në Republikën e Turqisë në Stamboll, në Arkivin Shtetëror të Republikës së Turqisë në Ankara; shfrytëzimi i dokumenteve të fondeve të shumta të arkivave vjeneze, bullgare, boshnjake, si dhe të burimeve statistikore gjermane, austriake, franceze, italiane etj. Së dyti, autori për përfundimin me sukses të këtij projekti ka shfrytëzuar një gamë të gjerë të lëndës bibliografike, që trajton demografinë historike nga autorët turq, evropianë, të vendeve të Ballkanit

dhe të autorëve shqiptarë, duke dhënë vlerësimin për çdo njërën prej tyre. Dhe, së treti, gjithë kjo lëndë i është nënshtruar analizës, konfrontimit e krahasimit nga autori, për të dhënë mbi këtë bazë vlerësime të qëndrueshme, që mund t'i bëjnë ballë kritikës shkencore.

Suksesit të akademik Kristaq Priftit, për arritjet e mëdha të kësaj vepre, i detyrohen rezultatet e një pune sistematike më se 20-vjeçare, duke ia dalë ta përcaktojë strukturën etnike, fetare e sociale të popullsisë së Kosovës, e të sjellë përfundime objektive e të qëndrueshme, të cilat bëhen kështu të besueshme të pakontestueshme. Po kështu veprën e bëjnë të qëndrueshme shkencërisht edhe një varg problemesh të tjera, që janë trajtuar dhe janë argumentuar, si një tërësi e studimit, tërësisht shkencor. Në suksesin e veprës ka ndikuar edhe njohja nga autori e osmanishtes, si një ndihmesë e madhe për të hulumtuar dhe për të studiuar lëndën kryesore arkivore në arkivat e përmendura osmane të Republikës së Turqisë.

Autori me të drejtë e trajton Kosovën si një provincë historike deri në themelimin e Vilajetit të Kosovës (1877). Duke u bazuar në kriteret e njohura etnike autori ia ka dalë të argumentojë me sukses se shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë në këtë provincë, ku flitej gjuha shqipe si mjet komunikimi dhe ku shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë. Kristaq Priftit e ka parë të arsyeshme që për këto kriteret të mbështetej nga etnografët, demografët, historianët e studiuesit e shek. XIX dhe ata të fillimit të shek. XX. Si rezultat i kësaj pune autori ia ka dalë të provojë se shqiptarët formuan konceptin "Shqipëri", si një koncept gjeopolitik dhe etnik, siç u formua edhe koncepti "Serbi", "Bullgari", "Greqi" etj. Autori ia ka dalë të nxjerrë përfundime të qëndrueshme se provinca e Kosovës përgjatë mesjetës identifikohet me provincën e Dardanisë, e që përfshinte edhe pjesë të Paionisë e një pjesë të trevës lindore ilire, me kryeqendër Shkupin. Kjo provincë, ishte e banuar me shumicë shqiptare, përjashtuar krahinën lindore të Nishit, trevën lindore të Leskocit, të Vrajës dhe viset e sotme të Maqedonisë Qendrore e Lindore, si dhe trevat në veri të Jeni Pazarit, ku shqiptarët përbënin pakicën e popullsisë kundrejt serbëve e boshnjakëve. Sipas autorit vetëm pas themelimit të Vilajetit të Kosovës, më 1877 Kosova përbënte një provincë administrative e politike të Turqisë Europiane (Rumelisë), që ishte njëkohësisht provinca më e madhe shqiptare dhe një nga më të mëdhatë e Perandorisë Osmane (me 32.900 km²).

Gjithnjë sipas argumenteve të qendrueshme të dokumentacionit osman dhe të veprave të studiuesve të huaj (si: J. Hahn, A. Bue, F. Bradashlka Th. Ippen, F. Lipich, V. Kënçov, A. Stranieri, S. Karastojanov, etj.), akademik Kristaq Prifti ka provuar se Kosova që nga fillimi i shek. XIX zinte një hapësirë gjeografike territoriale, që shtrihej në veri nga Pazari i Ri, në verilindje shkonte deri në Nish, e më pas në lindje përfshinte trevat perëndimore të Leskocit, të Vrajës e të Kumanovës, në juglindje të pellgut të Shkupit, e në lindje të Pollogut, deri në pllajat e Krushevës, dhe më pas duke përfshirë në veriperëndim krahinën e Lumës, Malësinë e Gjakovës dhe krahinën e Pejës, që përfshinte Rugovën, Plavën, Gucinë, Rozhajën.

Studimin e tij akademik Kristaq Prifti e ka parë të arsyeshme, që nga pikëpamja e qasjes metodologjike ta trajtojë e ta zbërthejë përmes shtatë kapitujve, të paraprirë nga parathënia e hyrja, e të pasuar nga epilogu, burimet, literatura kryesore dhe treguesi i emrave gjeografikë dhe të njerëzve. Vepra përshkohet nga një mori tabelash statistikore për strukturën fetare dhe etnike të Kosovës, me të dhëna për njësitë më të mëdha administrative-territoriale (ejaletet, apo pashallëqet) dhe të tabelave të shumta në nivel sanxhaku, kazaje, nahije e të pjesëve të tyre (atje ku është parë e arsyeshme), si dhe të qyteteve të sanxhaqeve e të kazave. Është pasqyruar struktura etnike e fetare e gjithë popullsisë të Kosovës: shqiptarëve, bullgarëve-maqedonë, serbëve, turqve, boshnjakëve, vlllehve, romëve dhe hebrenjve. Libri është ilustruar edhe me faksimile të dokumenteve të hulumtuara nga arkivat e Republikës së Turqisë, të hartave të trojeve etnike shqiptare e të Vilajetit të Kosovës.

Pjesën kryesore të veprës e përbëjnë rezultatet e regjistrimeve osmane të popullsisë, duke filluar nga regjistrimi i parë modern i vitit 1831 e deri tek regjistrimi i fundit i viteve 1905-1907. Përveç regjistrimit të parë të vitit 1831, që është përgatitur nga studiuesi turk Ever Zija Karal, i cili ruhet në formën e një libri në Bibliotekën e Stambollit, rezultatet e regjistrimeve të tjera të shfrytëzuara, janë të papublikuara deri më sot nga administrata osmane. Autori sjell kështu një dokumentacion të gjerë, të pasur, ende të pabotuar e të panjohur në historinë e demografisë osmane dhe të vendeve të Ballkanit, të hulumtuar prej tij pas një pune qëmtuese, këmbëngulëse shumëvjeçare në Arkivin Osman të Kryeministrisë në Stamboll.

Me informacionin e gjerë që sjell dhe me përfundimet që dalin prej tij, vepra hedh dritë mbi shtrirjen territoriale të Kosovës, mbi përbërjen

etnike përgjithësisht shqiptare të popullsisë së saj, mbi vazhdimësinë e pranisë së shqiptarëve në trojet e tyre etnike si popullsi autoktone, evidenton numrin e përgjithshëm të popullsisë sipas regjistrimeve të ndryshme osmane, peshën numerike të popullsisë shqiptare dhe raportin e saj me pakicat kombëtare, që banonin në këtë trevë.

Popullsia e Kosovës dhe përbërja e saj jepet me hollësi, në bazë vilajeti (province), sanxhaku (prefekturë) dhe kazaje (nënprefekturë), sipas çdo regjistrimi të popullsisë, ose sipas akteve, të depozituara dhe të ruajtura në administratën osmane, ose në fondet e arkivave diplomatike e konsullore të huaja.

Në hyrje autori u bën një vështrim burimeve të shfrytëzuara, në radhë të parë regjistrave osmanë (defterëve themeltarë e të përgjithshëm statistikorë - nyfus defterleri) të shek. XIX, si burim kryesor për hulumtimin e popullsisë së Perandorisë Osmane, me specifikat e tyre përkatëse, si dhe statistikave të institucioneve kishtarë serbe (patriarkiste) dhe të atyre bullgare (ekzarkiste), të arkivave të Europës e të vendeve të Ballkanit, të studimeve demografike për Perandorinë Osmane në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX në Republikën e Turqisë, si dhe të studimeve shqiptare për demografinë historike të Kosovës historike. Autori veçon me të drejtë kontributin e disa demografëve turq, evropianë, e të vendeve të Ballkanit, si dhe arritjet në këtë fushë të disa studiuesve shqiptarë.

Akademik Kristaq Prifti në mbështetje të rezultateve pozitive e të qëndrueshme shkencërisht të autorëve të huaj, sidomos të konsujve të huaj, të akredituar në disa qytete të Shqipërisë (Manastir, Shkup, Prizren, Shkodër e Mitrovicë), ia ka dalë me sukses të hedhë poshtë tezat e historianëve, gjeografëve e demografëve serbë për të ashtuquajturën “Serbi e Vjetër” (“Stara Srbija”), me të cilën synohej të imponohej ky term në diplomacinë evropiane, që të eklipsohej kështu termi Dardani, i njohur si i tillë përgjatë gjithë mesjetës, duke sjellë një mori provash të argumentuara për paqëndrueshmërinë shkencërisht të pretendimeve “shkencore” e politike serbe.

Autori ka atakuar gjerësisht tezën e njohur të historiografisë serbe e maqedonase, që mohon autoktoninë e shqiptarëve në Kosovën historike, duke pohuar se ata na ishin ardhacakë nga Shqipëria e Veriut, e se kishin zënë trojet e braktisura të serbëve ikanakë në Hungari (1689, 1690, 1737-1738) dhe kinse ishin vendosur aty nga pushtuesit osmanë. Ka hedhur poshtë këtë tezë si të paqëndrueshme, tendencioze e të sajuar për synime

politike, përmes argumenteve të qendrueshme arkivore e bibliografike, si dhe të rezultateve të historiografisë shqiptare e të huaj. Ka provuar se shqiptarët në provincën e Kosovës historike përbënin gjatë gjithë periudhave historike shumicën dërmuese të popullsisë.

Akademik Kristaq Prifti në çdo kapitull të veprës e ka parë të arsyeshme të flasë fillimisht për reformat administrative në Perandorinë Osmane, e në këtë kuadër për ndarjen territoriale-administrative të provincës së Kosovës përgjatë shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Në regjistrimin e vitit 1831 popullsia e provincës së Kosovës shtrihej në Ejaletin e Rumelisë, në Ejaletin e Silistrisë (Bullgari), në Ejaletin e Vidinit (kazaja e Nishit), dhe në Ejaleti e Shkupit. Pas ndryshimeve që u bënë më pas, Sanxhaku i Shkupit përfshinte pjesën më të madhe të Kosovës që kishte qenë deri atëherë në Ejaletin e Rumelisë, kur u formua Ejaleti apo Pashallëku i Shkupit, me qendër në Prizren.

Autori duke u mbështetur në rezultatet e regjistrimit të popullsisë së vitit 1862 provon se territori i Kosovës përfshihej në Ejaletin e Shkupit, në Ejaletin e Nishit, e të Bosnjës. Në ndarjen territoriale-administrative të vitit 1871, u themelua Vilajeti i Prizrenit, që përfshinte brenda kufijve të tij shumicën e territoreve të Kosovës, e më pas u themelua Vilajeti i Kosovës, me kryeqendër Prishtinën, e më pas Shkupin, që mori formën zyrtare me salnamenë perandorake. Argumentohet se me këtë reformë administrative Perandoria Osmane mori si shembull sistemin e departamenteve franceze, me të cilat synohej centralizimi i shtetit. Sipas kësaj reforme administrative-territoriale Vilajeti i Kosovës kishte në përbërjen e tij Sanxhakun e Prishtinës, të Prizrenit, të Shkupit, të Nishit, të Jenipazarit me kazatë e tyre përkatëse.

Në monografinë e K. Priftit provohet me argumente të qëndrueshme se si rrjedhojë e luftës ruso-turke (1877-1878) dhe e vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit (1878) Vilajetit të Kosovës iu shkëputën trojet e Sanxhakut të Nishit, përkatësisht kazatë e Prokuples, të Kurshumlisë, të Leskocit dhe të Nishit, që banoheshin në shumicë nga popullsia shqiptare, kazaja e Vrajës, me një popullsi të konsiderueshme shqiptare, sikundër edhe kazatë e Plavës, të Gucisë e të Rozhajës. Jepen prova se në viset e pushtuara ushtria serbe-malazeze kreu masakra mbi popullsinë shqiptare, nga të cilat u shpërngulën rreth 200.000 shqiptarë e një pakicë turke e boshnjake, të cilët u shpërndanë në Vilajetin e Kosovës e pjesërisht në vilajetet e tjera të Perandorisë Osmane.

Akademik Kristaq Prifti ka kontestuar në këtë vepër, po kështu tezën e historiografisë serbe, maqedone e bullgare, që popullatën e Gorës në jug të Prizrenit e në Maqedoni e konsideron si “maqedone-myslimane”, e cilësuar në kategorinë e ashtuquajtur “myslimanë sllavë”, e më pas e përfshirë në konceptin “kombi maqedon myslimanas”. Autori hedh poshtë këtë tezë të autorëve sllavë (bullgarë e maqedonë) dhe arrin në përfundimin se populli i Gorës, si dhe ai i trevave në Maqedoni, nuk ishte me origjinë sllave ,por ishte me origjinë dardano-ilire, duke argumentuar se ata edhe sot kanë tradita të përbashkëta me trevat shqiptare përreth, si dhe elemente të përbashkëta etnografike me Lumën etj. Qenien shqiptare ndër shekuj të Gorës e të Opojës autori e provon edhe me një varg argumentesh të sferës antoponimike, toponimike etj. Për këto autori provon të hedhë poshtë me sukses këtë tezë edhe përmes ndonjë studimi të autorëve shqiptarë e të konsullit italian A.Stanier. Në këtë kuadër hedh poshtë edhe përpjekjet e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë dhe të zëdhënësve të saj si Nijazi Limanovski etj., në vitet 80-të të shekullit të kaluar.

Akademik Kristaq Prifti ndonëse e ka pas shumë vështirë të përcaktojë strukturën përkatëse të popullsisë së Kosovës me statistikat zyrtare osmane (defterët, rrjedhimisht salnametë) që popullsinë e Perandorisë Osmane e jepnin sipas përkatësisë fetare (myslimane dhe të krishterë), ja ka arritur ta zgjidhë këtë çështje duke shfrytëzuar burime të tjera statistikore të vendeve ballkanike dhe evropiane. Për këtë ka shfrytëzuar të dhëna të dioqezave (eparkive) të kishës bullgare (ekzarkiste) dhe të dioqezave të kishës serbe (patriarkiste), harta të ndryshme, si dhe studime të autorëve osmanë, bullgarë, serbë, rumunë, grekë e evropianë, si dhe raporte të konsujve të huaj rezidentë në qytetet e ndryshme shqiptare. Kjo gamë e gjerë burimesh të proveniencave të ndryshme i është nënshtruar analizës së hollësishme për të ardhur tek rezultati sa më objektiv dhe i qëndrueshëm shkencërisht, për çka atij i detyrohet një meritë e veçantë.

Vend qendror në këtë studim zë struktura fetare dhe etnike e popullsisë së Kosovës historike përgjatë viteve 1831-1922. Provohet nga burimet e vjela në arkivat e përmendura, se në regjistrimin e vitit 1831 provinca historike e Kosovës ishte e banuar me shumicë shqiptare (40-60%), kundrejt bullgarëve-maqedonas (35.60%), serbëve (15%), turqve (6.40%), romëve (2.14%), si dhe një pakice simbolike të hebrenjve. Struktura etnike në kazatë e Kosovës, sipas këtij regjistrimi, e përpunuar

nga akademik Kristaq Prifti, ishte si më poshtë: në Kazanë e Nishit shqiptarët (myslimanë e katolikë) përbënin pakicën e popullsisë (10.15%), kundrejt serbëve, që përbënin shumicën e popullsisë (86%), dhe pakicave të tjera të papërfillshme. Në qytetin e Nishit shqiptarët (myslimanë e katolikë) përbënin një përqindje më të madhe në dallim nga kazaja (39%), kundrejt serbëve (37%). Në kazanë e Leskocit shqiptarët përbënin 28% të popullsisë, ndërsa në qytetin e Leskocit 33.3% të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Shqiptarët e dominonin kazanë e Prokuples (74.84%) dhe në Kazanë e Kurshumlisë (84.73%), kundrejt popullsisë serbe. Shqiptarët në kazanë e Vrajës përfaqësoheshin me 22.62% të popullsisë, kundrejt bullgarëve-maqedonas dhe serbëve, e minoriteteve të tjera. Ndërkaq, shqiptarët e dominonin qytetin e Vrajës (58%), kundrejt serbëve (38.5%). Kazaja e Pallankës (Kriva Pallanka) dominohej nga bullgarët-maqedonas dhe pakica turke. Edhe Kazaja e Kratovës dominohej nga bullgarët-maqedonas, ndërsa qyteti i Kratovës dominohej nga turqit (50%), kundrejt bullgarëve-maqedonas (45.8%). Kazaja e Kumanovës dominohej nga bullgarët-maqedonas (83%), kundrejt shqiptarëve (17.35%). Por popullsia shqiptare dominonte në pjesën përfundimtare të kësaj kazaje (sikurse edhe në atë të Preshevës, e të Vrajës). Shqiptarët në kazanë e Shkupit përbënin shumicën e popullsisë (50%), kundrejt bullgarëve-maqedonas, serbëve, turqve, romëve, vllëve e hebrenjve. Ndërsa në qytetin e Shkupit shqiptarët përfaqësoheshin me përqindje më të madhe se në kaza (64.57%), kundrejt popullsisë të tjera të përmendura më sipër. Kazaja e Radovishtit banohej nga shumica bullgare-maqedonas (58.3%), kundrejt popullsisë turke (me 41.6%) dhe minoriteteve të tjera. Kazaja e Shqipit banohej nga shumica bullgare-maqedonas (58%), kundrejt turqve (41.3%). Edhe kazaja e Koçanës dominohej nga bullgarët-maqedonas (60.1%), kundrejt popullsisë turke (35.5%). Kazaja e Quprilisë (Velesit) banohej nga shumica bullgare-maqedonase (71.14%), kundrejt turqve (26.66%). Kazaja e Kalkalendenit (Tetovës) banohej me shumicë shqiptare (58.22%), kundrejt bullgarëve-maqedonas (39.48%). Ndërsa qyteti i Tetovës përfaqësohej me strukturë më të lartë të shqiptarëve (75.32%), kundrejt bullgarëve-maqedonas (24.68%). Kazaja e Kërçovës banohej nga shumica e bullgarëve-maqedonas (68.87%), kundrejt shqiptarëve (30%), ndërsa qyteti i Kërçovës banohej me shumicë shqiptare (70%), kundrejt bullgarëve-maqedonas (19%). Kazaja e Prishtinës banohej nga shumica shqiptare (71.51%), kundrejt serbëve (22.73%). Ndërsa në qytetin e

Prishtinës shqiptarët përfaqësoheshin me përqindje më të lartë (80%), kundrejt popullsisë serbe (20%). Kazaja e Novobërdës (Gjilanit) banohej nga shumica shqiptare (57.44%), kundrejt serbëve (34.15%). Qyteti i Novobërdës banohej me shumicë shqiptare (85.3%). Kazaja e Prizrenit banohej me shumicë shqiptare (76.76%), kundrejt popullsisë serbe, turke, rome e vllahë. Shqiptarët në qytetin e Prizrenit përfaqësoheshin me strukturë më të lartë të popullsisë (79.20%), kundrejt serbëve (15.48%). Kazaja e Tërgovishtës (Rozhajës) banohej nga shumica shqiptare (52.04%), kundrejt serbëve (47.95%). Qyteti i Rozhajës banohej nga shumica shqiptare (52%), kundrejt serbëve (47.95%). Edhe kazaja e Bihorit banohej nga shumica shqiptare (52.12%), kundrejt serbëve (46.87%). Kazaja e Pejës banohej nga shumica shqiptare (60.18%), kundrejt serbëve, e pakicave të tjera etnike. Ndërsa qyteti i Pejës banohej me përqindje më të lartë të shqiptarëve (79%), kundrejt serbëve (20.6%). Në kazanë e Gjakovës shqiptarët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë (92.38%), kundrejt minoritetit serb (2.67%). Edhe në qytetin e Gjakovës shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë (89.14%). Kazaja e Jenipazarit banohej po kështu me shumicë shqiptare (73.61%).

Struktura e mësipërme e popullsisë në Kosovën historike është përafërsisht e ngjashme edhe në regjistrimet e tjera të popullsisë, e shprehur në tabelat përkatëse përgjatë gjithë regjistrimeve të viteve 1831-1912. Përjashtim bëjnë trevat e pushtuara nga Serbia e Mali i Zi dhe njohja e tyre brenda kufijve të atyre shteteve me vendimet e Kongresit të Berlinit. Atëherë trevat e Sanxhakut të Nishit, dhe trevat e pushtuara nga Mali i Zi u zbrazën pothuaj plotësisht nga shqiptarët, si rrjedhojë e ushtrimit të dhunës së ushtrisë serbe e malazeze.

Janë me interes të veçantë të dhënat e autorit për Regjistrimin e fundit osman të viteve 1905-1907, të cilin K.Prifti e ka nxjerrë nga fondet e administratës osmane, në dorëshkrime të pabotuara. Nga këto dorëshkrime autori ka veçuar Tabelën e përgjithshme statistikore të popullsisë së Vilajetit të Kosovës, që është hartuar në vitin 1910, por që ka mbetur si dorëshkrim në arkivin osman, i panjohur dhe i pashfrytëzuar nga studiuesit për statistikat e Regjistrimit të Viteve 1905-1907.

Të dhënat e këtij regjistrimi që autori i ka hulumtuar në Arkivin Osman të Kryeministrit në Stamboll, e që i ka botuar në formën e tabelave statistikore në këtë monografi mbeten deri më sot një burim i rëndësishëm dhe kryesor i administratës osmane për popullsinë e Vilajetit

të Kosovës e të vilajeteve të tjera shqiptare deri në vitin 1912 e pas tij. Mbështetur në rezultatet e këtij regjistrimi autori ka arritur në përfundimin se vilajeti i Kosovës përbënte njësinë më të madhe territoriale-administrative të Turqisë Europiane, me një popullsi të përgjithshme prej 1.257.440 frymësh. shumicën e së cilës e përbënin shqiptarët 687.777 frymë, që ishin myslimanë e një pjesë katolike e ortodoksë.

Autori e ka parë të arsyeshme të pasqyrojë strukturën etnike të popullsisë së Vilajetit të Kosovës pas ndryshimeve që ndodhën pas vendimeve të Kongresit të Berlinit. Këtë strukturë të regjistrimit të fundit në Perandorinë Osmane të viteve 1905-1907, e ka dhënë duke u mbështetur në fondet arkivore të Kryeministrit të Turqisë, si dhe në statistikat e ndryshme të vendeve evropiane, gjithashtu në një fond të gjerë të literaturës relevante, që ka të bëjë me këtë problem. Ka marrë në konsideratë vetëm burimet dhe literaturën që i ka konsideruar të qëndrueshme, e ka hedhur poshtë literaturën destruktive, me prapavijë politike, sidomos të autorëve të vendeve fqinje. Dëshmohet se sipas regjistrimeve të viteve të mësipërme shumicën e popullsisë në Vilajetin e Kosovës e përbënin shqiptarët (myslimanë e katolikë, 54.32%), kundrejt serbëve (17.83) dhe bullgarëve-maqedonas (15.51%), turqve (5.85%), boshnjakëve (4.54%), romëve, vlllehve e hebrenjve, që përbënin një përqindje simbolike. Sipas këtij regjistrimi në kazanë e Shkupit shqiptarët kishin shumicën (57.35%), kundrejt popullsisë bullgare-maqedonase (30.31%) dhe popullsisë serbe (7.59%). Pasonin pakicat etnike si: hebrenjtë, romët dhe vlllehtë. Qyteti i Shkupit banohej me shumicë shqiptare (62%), kundrejt bullgarëve-maqedonas (27%), serbëve, romëve, vlllehve e hebrenjve. Në Kazanë e Kumanovës shumicën e përbënin bullgarët-maqedonas (40.42%), kundrejt shqiptarëve (37.32%) dhe serbëve (20.37%), si dhe një numri të vogël vlllehësh, romësh e hebrenjsh. Në qytetin e Kumanovës shumicën e përbënin shqiptarët myslimanë (47.61%), pas tyre vinin bullgaro-maqedonasit (29.76%) dhe serbët (14.68%), të pasuar nga një numër i vogël i vlllehve, romëve dhe hebrenjve. Kazaja e Shtipit dhe Kazaja e Radovishtes banoheshin nga shumica myslimane (turke dhe një pakicë shqiptare), ndërsa Kazaja e Kaçanikut banohej me shumicë dërrmuese shqiptare (99.18%). Në Sanxhakun e Prishtinës shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë (70%), kundrejt serbëve (28.19%), boshnjakëve, turqve, vlllehve dhe hebrenjve. Edhe në Sanxhakun e Prizrenit shqiptarët ishin shumicë (82.38%), të

pasuar nga serbët (12.54%) dhe nga bullgarët-maqedonas (12.54%). Në Sanxhakun e Pejës shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë (85.22%), kundrejt serbëve (13.57%) dhe pakicave të tjera. Në Sanxhakun e Tashlixhes boshnjakët myslimanë kishin shumicën e popullsisë (54%), të pasuar nga serbët (45.28%), nga pakica shqiptare etj.

Akademik Kristaq Prifti ia ka dalë me sukses të argumentojë se struktura e popullsisë shqiptare në Kosovën historike, në Vilajetin e Kosovës realisht duhej të ishte më e lartë, sepse shqiptarët i shmangeshin regjistrimeve të Perandorisë Osmane për shkak të taksave, që duhej të paguanin dhe për t'iu shmangur detyrimit të shërbimit ushtarak. Është argumentuar, po kështu se shqiptarët ortodoksë përbënin diku një pakicë në trevën e sotme të Maqedonisë, sidomos në Shkup etj., që po të mund të evidentoheshin çonin në rritjen e përqindjes së përgjithshme të shqiptarëve në vilajet (regjistrimi i popullsisë së Vilajetit të Kosovës për vitet 1896-1900, 150 frymë). Këto argumente mbështeten edhe nga një anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.

Akademik Kristaq Prifti, që është i njohur për qëndrimin e tij parimor e objektiv kundrejt problemeve të trajtuara, edhe në këtë vepër nuk bie pre e ndonjë informacioni të pakonfirmuar nga burime të tjera, që do të ishte në favor të strukturës etnike shqiptare. Kështu ai qëndron në lartësinë e detyrës së shkencëtarit. Ndërkaq, përmes të dhënave të qendrueshme shkencërisht, i jep përgjigjen e merituar tendencave subjektive të autorëve të vendeve ballkanike, që, përmes statistikave të sajara me prapavijë politike, kanë synuar gjithnjë të shtrembërojnë realitetin. Ato i hedh poshtë përmes argumenteve të shumta arkivore bibliografike dhe të raporteve të konsujve të huaj, që i ka shfrytëzuar në këtë vepër.

Për sa më sipër, mund të konstatohet me të drejtë se akademik Kristaq Prifti në monografinë e tij të fundit "Popullsia e Kosovës 1831-1912" begaton historinë demografike në Kosovë gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, çka paraqet interes të veçantë në njohjen me vërtetësi të përbërjes etnike të Kosovës dhe të trevave shqiptare në Maqedoninë Veriore, në Luginën e Preshevës dhe në pjesën jugore të Sanxhakut të Jeni Pazarit gjatë shek.XIX dhe në fillimet e shek.XX. Ajo përbën kulmin e arritjeve për shkencën shqiptare e më gjerë, për periudhën në fjalë. Prandaj kjo vepër do të shërbejë si një pikë referimi në studimet e mëtejshme për historinë e Kosovës, në shumë rrafshet etj.

RAMIZ ABDYLI

